

RREGULLORE

**PËR STUDIMIN PJESOR URBANISTIK NË FSHATIN
LANABREGAS, KOMUNA DAJT, QARKU TIRANË**

MIRATOHE



**KRYETARI I KËSHILLIT TË RREGULLIMIT TË TERRITORIT TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

SALI BERISHA

**KRYETARI I KËSHILLIT TË RREGULLIMIT TË TERRITORIT TË
KOMUNËS DAJT**

KUJTIM QEFALIA



MIRATUAR ME VENDIM TË K.RR.T.R.SH. Nr. 14... Dt. 14.07.2009

RREGULLORE

MBI ZBËRTHIMIN DHE ZBATIMIN E STUDIMIT PJESOR URBANISTIK

POL HOTELJER, TREGTAR, REZIDENCIAL DHE AKTIVITETESH NE ZONEN LANABREGAS TE KOMUNES SE DAJTIT

Kjo rregullore i bashkëngjitet “ Studimit pjesor urbanistik pwe zhvillimin e nje poli hoteljer, tregtar, rezidencial dhe aktivitetesh në komunën e Dajtit të miratuar me vendim nrdt..... të K.RR.T.R.SH. mbështetur ne ligji 8405 “ Për urbanistikën” dt. 17.09.1998.

Kjo rregullore ka për qëllim zbërthimin dhe zbatimin e këtij studimi dhe disiplinimin e zhvillimit urbanistik të zonës.

Kreu i parë

DISPOZITA TË PËRGJITHËSHME

Neni 1

Kjo rregullore është pjesë e pandarë e studimit pjesor urbanistik për zhvillimin e një poli hoteljer, tregtar, rezidencial dhe aktivitetesh në komunën e Dajtit dhe përfshin të gjitha fazat e planit afat shkurtër dhe afat gjatë për zhvillimin e kësaj zone.

Neni 2

Zbatimi i kësaj rregullore siguron mbrojtjen e vlerave të zonës, siguron zhvillimin e territorit, organizimin e funksioneve të parashikuara në studim duke garantuar zhvillimin e qëndrueshëm të saj.

Neni 3

Të gjitha llojet e planifikimeve, studimeve, zhvillimeve dhe ndërtimeve, që nga pushteti lokal dhe persona fizikë dhe juridikë të licensuar, duhet të kryen në përputhje me kriteret e përgjithëshme që parashikon “Studimi pjesor urbanistik per zhvillimin e nje poli hoteljer, tregtar, rezidencial dhe aktivitetesh ne komunën e Dajtit” dhe kjo rregullore. Cilido studim pjesor ose veprimtari ndërtuese në hapësirën e studimit, që nuk kryhet në përputhje me kriteret e përcaktuara nga ky studim dhe kjo rregullore,

konsiderohen të pa ligjëshme dhe shkelje e ligjit “Për Urbanistikën” dhe Rregullores së urbanistikës.

Neni 4

Studimi “Studimi pjesor urbanistik per zhvillimin e nje poli hoteljer, tregtar, rezidencial dhe aktivitetetsh ne komunen e Dajtit” u krye në zbatim të planit rregullues për parkun kombëtar të Dajtit të miratuar me vendimin e K.RR.T.R.SH. Nr. 9 dt 06. 04. 1994 si dhe vendimit të Këshillit të ministrave nr. 402 dt 21. 06. 2006 neni 4/ç

Kreu i dytë

PËR ZBËRTHIMIN DHE ZBATIMIN

“Studimit pjesor urbanistik per zhvillimin e nje poli hoteljer, tregtar, rezidencial dhe aktivitetetsh ne komunen e Dajtit”

Neni 5

Vend ndodhja dhe përcaktimi i kufijve të zonës

Vend ndodhja e kompleksit është rreth 9 deri 10 km larg qendrës së Tiranës, në një shpat të gjelbëruar të malit të Dajtit, pak para hyrjes në parkun kombëtar. Zona shtrihet në lartësitë e kodrës në verilindje të fshatit Lanabregas dhe kufizohet nga rruga nacionale drejt parkut kombëtar Dajt dhe majës së kodrës në lartësinë 720 m mbi nivelin e detit.

Zona lidhet me Tiranën nëpërmjet rrugës që shkon në Qafë Priskë dhe lartësitë e parkut të Dajtit. Një tjetër mundësi e vajtjes në zonë është drejtimi nga rruga e Elbasanit, nëpër komunën e Farkës në rrugën pranë fushës së helikopterëve drejt fshatit Lanabregas. Lidhje tjetër mund të funksionojë drejtimi Lanabregas—uzina e Traktorëve- Tiranë. Në këtë mënyrë zona rezulton lehtësisht e arritëshme nga disa drejtime, si të qendrës edhe të periferisë së Tiranës.

Neni 6

Zonimi funksional i projektuar në

“Studimin pjesor urbanistik per zhvillimin e nje poli hoteljer, tregtar, rezidencial dhe aktivitetetsh ne komunen e Dajtit”

Idetë orientuese funksionale për konceptimin e kësaj qendre janë :

Zonimi i qartë dhe kompakt funksional i mbështetur në pesë komponentë

